

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Prishtinë - Edhe sot protestë kundër vendimit të Speciales ndaj ish-krerëve të UÇK-së
ADRESA	https://www.syri.net/kosova/917493/edhe-sot-proteste-kunder-vendimit-te-speciales-ndaj-i-sh-krereve-te-uck-se/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 07:42:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 07:16:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	200d8fb68e9e8b5137a780421716ce936f86c28c1b02ff271023d048b43b82d4
TEKSTI	129fdb81e2ca1a4ac69bef13799438b867524b009ddf720baca403337d53a6ed
PAMJA	6e9b5ac018aa9018b029ae273bf042cceb449762e651ff55b398194b44faa78

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	871684a09b103056514083287cec15c1fbe99f53ded00582d536b4803d96fe72
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	401dcaf3311c18d7b93cbabfd522e0d009d4ac62bab22fd89058a16395500d64
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/871684a09b103056514083287cec15c1fbe99f53ded00582d536b4803d96fe72>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



SONILA MEÇO
'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



ÇIM PEÇA
Nga Çim Peça-Tradhtia që s'e panë tu ardhë



më të lexuarat

A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani Konrad Clewing! Faji individual, lufta e Kosovës dhe kufijtë...

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Taçi ishte anëtar kyç

'Taçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

Granit Xhaka në mbështetje të çlirimtarëve: Luftuan në tokën e tyre për lirinë e atdheut!

Trupi gjyqësor: Krasniqi kishte dijeni për krimet, por nuk ndërmori hapa

Gjykata Speciale: Katër të akuzuarit janë

Edhe sot protestë kundër vendimit të Speciales ndaj ish-krerëve të UÇK-së

09:16, 18/09/2026

Organizata e Veteranëve të Luftës ka thirrur protestë gjithëpopullore për sot në orën 12:00 në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, për të kundërshtuar vendimin dënues të Speciales ndaj katër ish-udhëheqësve të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

Të enjten në një konferencë për media nënkryetari i kësaj organizate, Gazmend Syla, ka thënë se protesta do të jetë paqësore dhe se për dhunë e persona me maska nuk do të ketë vend.

"Ju e dini, nuk është vendim i padrejtë vetëm ky i djeshmi. Me bashkëluftëtarë tanë, ish-luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë mbushur burgje në kohën e UNMIK-ut me ish-udhëheqës të UÇK-së", ka thënë Syla. "Protesta jonë që organizohet nesër është paqësore, jo e dhunshme, pa maska, me fytyrat tona, kemi çka me tregu boll, fytyrat i kemi te ndershme, s'kemi nevojë fare të vendosim maska në protestë".

Kjo ka qenë përgjigje për protestën e organizuar deri në orët e vona të mërkurës, menjëherë pas verdiktit dënues. Në mesin e protestuesve pati edhe të maskuar, ndërkaq me mjete të forta janë thyer edhe xhama të ndërtesës së Qeverisë.

Duke folur për vendimin e së mërkurës ndaj katërshes së UÇK-së, Syla ka thënë se me të është dënuar lufta për çlirim dhe se është tentuar të bëhet një balancë me krimet e kryera nga serbët gjatë luftës.

"Asnjë vendim nuk mund ta rishkruajë luftën tonë çlirimtare apo t'i njollojë ata që luftuan për liri. Që nga fillimi e kemi quajtur këtë gjykatë politike dhe procesin të pa-drejtë, gjë që sipas nesh, u dëshmtua edhe dje", ka thënë ai.

Përfaqësues të organizatës së veteranëve kanë shpalosur edhe një platformë për hapat kundërshtues që duhet të merren deri në përfundimin e procesit gjyqësor në shkallën e dytë, për rastin ndaj Hashim Taçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit e Rexhep Selimit.

Në platformë parashihet edhe një rivlerësim institucional i Dhomave të Specializuara, duke e lidhur atë me procesin që çoi në krijimin e këtij mekanizmi.

Një prej kërkesave kryesore të platformës është amendamentimi ose shfuqizimi i Ligjit për Dhomat e Specializuara.

"Të kërket debat i posaçëm parlamentar dhe shqyrtim juridik i amendamentimit

ose shfuqizimit të Ligjit për Dhomat e Specializuara. Kërkesa duhet të mbështetet në Memorandumin Juridik që analizon bazën kushtetuese, dëshmitë relevante dhe pasojat e secilës alternativë. Rivlerësimi duhet të trajtojë edhe raportin ndërmjet pretendimeve që ishin pjesë e procesit që çoi në krijimin e mekanizmit, përfshirë raportin e Këshillit të Evropës, trajtimin e gjerë të organeve, mandatit të gjerë që iu dha Dhomave dhe rezultateve konkrete të hetimeve dhe proceseve", ka thënë Fatmir Sopî, nënkryetar i organizatës së veteranëve të UÇK-së.

Platforma parasheh gjithashtu mbështetje të plotë juridike dhe financiare për proceset në Apel.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Hashim Thaçi reagon pas vendimit në Hagë: Mohoj çdo përfshirje në vrasje, do ta apeloj vendimin



Shënohet rasti i parë i vdekjes në Kosovë nga Virusi i Nilit Perëndimor



Bosch: Presidenti i ri i Kosovës, mbase mund t'i falë të dënuarit nga Specialja

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

penalisht përgjegjës për krime lufte!

Ndërron jetë Flora Brovina, nesër do të dëshmonte për Masakrën e Dubravës

Hashim Thaçi dënohet me 25 vjet burgim për krime lufte

TË NGJASHME



FOTO/ Shqiptarët protestojnë në Times Square pas aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së



Hamza: Vendimi në Hagë i padrejtë, PDK do të ndërmarrë veprime konkrete



Protestë mbarëpopullore nesër në Prishtinë



Trajneri Franco Foda flet për largimin e Rrahmanit nga Kosova: Nuk ka bojkot



Protesta në Prishtinë/ Studentët kërkojnë drejtësi për ish-krerët e UÇK-së



Kur Albin Kurti paralajmëronte Kuvendin e Kosovës: VV nuk e njeh Gjykatën Speciale, ne nuk do të dorëzojmë luftëtarët e UÇK

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTE KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MËDIJË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.